

Zyrës për Doktoraturë të Universitetit të Tetovës
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **28.09.2023** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: “*Funksioni i parafjalëve arabe në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe – Rasti i përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës*” të kandidatit **Mr. Dritan Skenderi**.

Në bazë të vendimit **16-378/3** të datës **28.09.2023**, Komision i përbërë nga: **Prof. dr. Metin Izeti** (kryetar), **Prof. dr. Sulejman Baki**, **Prof. dr. Ziber Lata**, **Prof. dr. Izmit Durmishi** (anëtarë) dhe **Prof. dr. Adnan Ismaili** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

REFERAT

Mr. sc. Dritan Skenderi, është i lindur më 10.11.1982, në Reçicë të Vogël - Tetovë, shkollën fillore dhe të mesme (Gjimnazin) i ka kryer në Tetovë. Studimet e para deridiplomike i ka kryer në Universitetin e Tetovës në qershori 2008, fakulteti Juridik; ndërsa studimet e dyta deridiplomike i kreua në nëntor 2013, në të njëjtin Universitet, në Filologji Orientale, drejtimi - Gjuhë dhe letërsi arabe me notë mesatare 9.73. Studimet pasdiplomike (Master) i vazhdoi poashtu në të njëjtin Universitet dhe në të njëjtin drejtim, të cilat i përfundoi në qershori 2016, me tezë “Aspekti semantiko-gjuhësor i katër termave në Besmele”, me notë mesatare 9.90. Studimet e doktoraturës i filloi në vitin akademik 2018/2019, po në Universitetin e Tetovës, fakulteti Filozofik, programi studimor - Shkenca mbi gjuhën, drejtimi - Filologji orientale, me notë mesatare 10.00.

Nga Janari 2014 ai është i angazhuar si asistent part-time në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik, programi studimor Filologji Orientale. Ka marrë pjesë në disa konferenca, simpoziume, seminare, shkolla verore dhe kurse të ndryshme në Maqedoni, Bosnje, Turqi dhe

Jordan. Ai i përfundoi me sukses të gjitha nivelet e kursit të gjuhës arabe për jo arabfolësit në Qendrën e Gjuhëve në Universitetin e Jordanit në Aman të Mbretërisë Hashimite të Jordanisë. Në nentor 2018 ka marrë pjesë në Sarajevë në seminarin trajnues për mësimdhënësit e gjuhës arabe për jo arabfolësit, ndërsa në janar të 2020 në Stamboll, poashtu në seminarin trajnues për mësimdhënësit e gjuhës arabe për jo arabfolësit.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoraturës

Kandidati Dritan Skenderi që nga fillimi studimeve të ciklit të tretë në vijimësi ka treguar përparim dhe formim të mjaftueshmëri në fushën e hulumtimit dhe punimin e temës. Kandidati me sukses ka realizuar tre konferencat doktoriale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Mr. Dritan Skenderi gjatë studimeve të doktoraturës ka botuar tezën e masterit në gjuhën angleze që lidhet edhe me tezën doktoriale, ka prezantuar tre punime shkencore të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me disertacionin e doktoraturës:

1. *Semantic-linguistic aspects of the four terms in Besmeha*, teza e magjistraturës e publikuar në gjuhën angleze, nga LAMBERT Academy, Janar 2020.
1. “*Funksioni i parafjalëve arabe në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe*”, Konferenca e dytë doktoriale, fakulteti Filozofik, UT, 2019/2020
2. “*The translation and interpretation of the Islamic Religious concepts into albanian language*”, PHILOSOPHICA - International Journal of Social and Human Sciences, Vol. 7, no. 13/14, Tetovë, 2020
3. “*The presence of Besmela in the Albanian culture and literature*”, International Congres on Human, Social Science and Arts, 7th International Scientific Conference of the Faculty of Philosophy (16-18 November, 2022), bashkautor me mentorin prof. dr. Adnan Ismaili,

Analizë e punimit "FUNKSIONI I PARAFJALËVE ARABE NË PËRKTHIMET E KUR'ANIT NË GJUHËN SHQIPE – Rasti i përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës"

Kandidati temën e ka ndarë në pesë kapituj, ku në kapitullin e parë ka folur për Parafjalët – Definicjonin dhe Ndarja e tyre ku i ka paraqitur si denfinicionin ashtu edhe rolin dhe funksionin e tyre në fjali duke e ilustruar edhe me shembuj të caktuar;

Në kapitullin e dytë ka folur për Disa nga parafjalët arabe më të përdorura – me çrast i ka shkoqitur kuptimet, karakteristikat, pozicionin dhe funksionin e tyre në fjali si dhe në nuancat e ndryshme kuptimore që përfitohen nga e njejtë parafjalë në kontekste të ndryshme në fjalitë përkatëse, poashtu duke i lustruar që të gjitha me shembuj të caktuar veç e veç si për nga kuptimi e funksioni ashtu edhe për nga përdorimi si ngajeta e përditshme ashtu edhe nga porosia hyjnore qoftë nga Zbulesa qoftë nga Tradita profetike;

Në kapitullin e tretë i ka paraqitur Parafjalët më të përdorura në Kur'an – ku ka shtruar disa raste me analiza dhe sqarime të parafjalëve si dhe përkthimin e parafjalëve më të përdorura në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe me çrast ka vënë në dukje edhe faktin se në gjuhën shqipe parafjalët e caktuara marrin kuptimin e pjesëzave thekson kujdesin e shtuar që duhet patur gjatë përkthimit dhe përdorimit të të njejtave duke pasur për qëllim që të mund të përcillet sa më original ideja dhe porosia e Zbulesës hyjnore;

Në të katërtin e ka paraqitur dhe e ka shtjelluar thelbin dhe shtyllën e disertacionit, respektivisht Përkthimin e Kur'anit nga Salih Ferhat Hoxha, më drjet përkthimin dhe përdorimin e parafjalëve më të përdorura arabe në përkthimin e Salih Ferhat Hoxhës, me çrast me ca fjale ka folur rreth përkthimit të Kur'anit, pastaj rreth përkthimit dhe përdorimit të parafjalëve arabe në Përkthimin e Salih Ferhat Hoxhës, dhe në fund ka paraqitur edhe krahasime ilustruese të përkthimit dhe të përdorimit të parafjalëve ndërmjet Përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës dhe përkthimeve të tjera të Kur'anit në gjuhën shqipe;

Kurse në kapitullin e pestë dhe të fundit ka dhënë Vlerësim dhe Përfundime të arrira nga tema në fjale.

Dhe në fund fare, sigursusht, pason edhe Literaturën e shfrytëzuar.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë punimit të temës janë shfrytëzuar metodat bashkëkohore të hulumtimit shkencor, pastaj të dhënat e deduktuara nëpërmjet të metodave matëse shkencore janë krahasohen me konkluzat burimore të temës në fjalë, gjithsesi që janë të besueshme, dhe si rezultat i kësaj janë prezantuar përmasat e sakta të tyre për temën.

Është me rëndësi të theksojmë se burimet dhe literatura e shfrytëzuar nga kandidati, përveç gjuhës origjinale të Zbulësës hyjnore – arabishtes, ka shfrytëzuar edhe burime nga gjuhë të tjera si orientale ashtu dhe oksidentale, si nga turqishtja, anglishtja dhe boshnjakishtja.

Studimi ka ndjekur metodologjinë themelitore shkencore të punimeve gjuhësore në bazë të së cilës janë paraqitur konkluzat, objektivat shkencore në lidhje me temën në fjalë.

Meqë bëhet fjalë për hulumtim kualitativ (cilësor), pas konstatimit të literaturës gjegjëse, është bërë leximi dhe deduktimi i çështjeve që në trajtë të drejtpërdrrjet kanë të bëjnë me temën, gjurmimi i literaturës në gjuhët orientale dhe oksidentale, krahasimi i tyre me fenomenet gjuhësore bashkëkohore dhe ka vazhduar me bartjen dhe prazantimin e tyre në kuadër të studimit në fjalë.

Theks i veçantë është shënuar mbi mundësinë e kuptimësise së gjuhës së Zbulësës në aspekt të qasjes së përbotshme, pastaj krahasimi i konkluzave në literaturën e përgjithshme, e cila pasohet me analizën e parafjalëve në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe – me fokus ne përkthimin e Sallih Ferhat Hoxhës, si dhe krahasimi i funksionit të parafjalëve arabe me ato shqipe në konkluzat e deduktuara nga përkthimi në fjalë.

Gjatë punimit të temës, në aspekt statistikor dhe analistik, janë përmendur konkluzat e burimeve të kësaj çështjeje në gjuhësinë orientale, me shembuj konkret edhe nga gjuha shqipe. Dhe, në fund, është bërë përpunimi i të dhënavëve edhe sipas metodave të Komparacionit dhe të Përshkrimit.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Pas prezantimit të opinioneve dhe analizave të bëra në lidhje me temën, si rrjedhojë e nevojës së origjinalitetit të studimit shkencor, është bërë interpretimi objektiv i tyre, gjithnjë duke e patur parasysh ndikimin e tyre në gjuhësinë bashkëkohore, me theks të posaçëm në gjuhën shqipe. Nëpërmjet të temës “*Funksioni i parafjalëve arabe në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe – Rasti i përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës*” është synuar që të arrihet në këto përfundime:

- Që, nëpërmjet të analizës së parafjalëvenë literaturën originale orientale, si dhe qasjet oksidentale për to, në trajtë analitike, të konstatohet vlera dhe funksioni i tyre në gjuhësinë shqipe;
- Si rezultat i krahasimit të këtyre parafjalëve me të ngjashmet në gjuhësinë shqipe, të konstatohet vendi dhe funksioni i tyre në përkthimin e Kur'anit në gjuhës shqipe;
- Të hapen shtigje të reja për analizë më të hollësishme të evenimenteve gjuhësore, kulturore, për hulumtimet e ardhëshme.

Tema është punuar nën përkujdesje të vazhdueshme të mentorit, duke filluar nga konstatimi i literaturës gjegjëse, leximi dhe deduktimi i çështjeve që në trajtë të drejtpërdrrjet kanë të bëjnë me temën, gjurmimi i literaturës në gjuhët orientale dhe oksidentale, krahasimi i tyre me fenomenet gjuhësore bashkëkohore dhe ka vazduar me bartjen dhe prazantimin e tyre në kuadër të studimit në fjalë. Për shkak se bëhet fjalë për një temë e cila është e përqëndruar në përmasën gjuhësore të analizës, pasi janë bërë analizat e ndara është kaluar në bashkimin e të dhënavë të trajtë të shkruar, gjë për të cilën është dashur punë intensive për një periudhë kohore disa muajshe...

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Parafjalët arabe dhe funksioni i tyre në përdorime të gjithanshme si dhe në përkthimet apo interpretimet e Kur'anit në gjuhët orientale janë përpunuar në detaje, por në gjuhën shqipe ka vetëm disa punime që mund të numërohen me gishta, sa për të mos thënë se nuk ka fare, sepse punime të kësaj natyre në gjuhën shqipe gjiejme vetëm nëpër gramatikat shkollore apo

universitare nëpër të cilat është e paraprare si lëndë gjyka arabe, dhe kryesisht janë Medresetë dhe fakultetet e shkencave – studimeve islame. Por ato nuk e kanë objekt studimi lëndën tonë, megjithëse hasen shembuj e ilustrime nga përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe.

Është edhe kritika e Emin Behramit mbi përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe - *Qasje studimore rreth katër përkthimeve të KUR'ANIT në gjuhën shqipe*, botuar në Prishtinë më 1997 - por as ai objekt studimi nuk e ka lëndën tonë, respektivisht funksionin e parafjalëve arabe dhe përkthimin dhe përdorimin e tyre në gjuhën shqipe. Pikërisht për këtë hulumtimi i tyre nga aspekti i ndikimit të tyre në gjuhën shqipe dhe në kulturën shqiptare, dhe në atë të përgjithshme njerëzore, është mëse e rëndësishme. Aq më tepër përfaktin se rasti ynë ka të bëjë me një përkthim unik, pasi është bërë nga një autor i cili nuk ka qenë fare i ndikuar nga përkthimet simotra të gjuhëve fqinje apo të tjera, pasi qe ai ka jetuar dhe vepruar në Shqipëri në kohën e regjimit monist totalitar dhe të izoluar totalisht, sa që edhe po të kishte dashur të shërbehet me përkthimet nga gjuhë të tjera e ka pasur të pamundur qasjen e tyre.

Nisur nga fakti që numri i parafjalëve në gjuhën arabe, siç thekson kandidati, nuk e kalon mbi 80 dhe të gjitha ato janë të pandryshueshme, dhe shumica apo më të përdorshmet e tyre gjithmonë janë në rasën gjinore si الباء، من، إلى، على، في، الكاف، اللام، وأو القسم، قاء القسم، حتى، منذ etj., shto kësaj që çdo parafjalë ka më shumë se tre-katër kuptime, ku përfaktim ka përmendur se vetem parafjala الباء ka 16 kuptime, sigurisht se ka qenë i detyruar që të kufizohet vetëm në trajtimin dhe analizën e disa parafjalëve të caktuara më të përdorura, pasi kjo kërkon një hulumtim dhe punim shumë të zgjeruar dhe voluminoz, gjë që do ta stërvngarkonte dhe mbivështirësonte punën tonë.

Studimi përpinqet që në hollësi ti definojë parafjalët dhe funksionet e tyre dhe ta paraqesë ndikimin e tyre, me shembuj konkret, në përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, respektivisht në përkthimin e Salih Ferhat Hoxhës, si një përkthim më i pastër gjuhësor dhe kulturor shqiptar, i cili do të shërbejë edhe si ilustrues i pëkajjes, konceptimit dhe manifestimit të mesazhit të Zbulesës hyjnore në mentalitetin, kulturën dhe gjuhën shqipe. Hipotezat e parashtruara në temë mbulohen me prova teorike dhe pragmatike në fushën e gjuhësisë. Hipotezat fillestare në bazë të të cilave ndërtohet struktura e temës në fjalë janë: vendzënia e parafjalëve të caktuara arabenë organizmin gjuhësor të saj, arabishtes, dhe si refleksion i tyre në gjuhën shqipe; përmasa

subjektive dhe objektive e tyre në gjenealogjinë e gjuhës; Sinjifikimet gjuhësore dhe semiotike të tyre në filozofinë dhe kulturtën e gjuhës; etj..

Hulumtime të mundshme të ardhshme

Tema “*Funksioni i parafjalëve arabe në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe – Rasti i përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës*” sa ka rëndësi shkencore gjuhësore po aq edhe rëndësi kulturore e shpirtërore, aq më tepër në përcjelljen e idesë dhe porosisë së Zbulesës hyjonre që është universale, me çka kandidati është munduar që të hap shtigje të reja në percjelljen e kësaj ideje dhe porosie në nënqiellin dhe në kulturën gjuhësore shqiptare duke vënë në dukje rëndësinë e përkthimit dhe përdorimit sa më të drejtë edhe të vetë parafjalëve arabe. Parafjalët e gjuhës arabe kanë rëndësi të posaçme në përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, respektivisht në zberthimin e përgjithshëm të zbuluesës hyjnore dhe, si rrjedhojë e saj, edhe të interpretimeve të mesazhit hyjnor si në aspektin doktrinar ashtu edhe në vënien e raporteve të gjithanshme ndërshoqërore si ndërmjet myslimanëve ashtu edhe ndërmjet pjestarëve të besimeve, respektivisht seve të tjera. Si rrjedhojë, ai ka vënë në dukje edhe faktin se në gjuhën shqipe parafjalët e caktuara marrin kuptimin e pjesëzave, gjë që shton nuancat e ndryshme kuptimore që përsitohen nga e njëjta parafjalë në kontekste të ndryshme në fjalitë përkatëse, ndaj ai thekson kujdesin e shtuar që duhet patur gjatë përkthimit dhe përdorimit të të njëjtave duke pasur përqëllim që të mund të përcillet sa më original ideja dhe porosia e Zbulesës hyjnore

Gjithashtu edhe në raportet ndërmjet pjestarëve të një brendakulture e qytetërimi të caktuar, si dhe në raportet ndërmjet kulturave e qytetërimeve të ndryshme. Analiza në fjalë gjithashtu është e një rëndësie të veçantë edhe për kuptimin e drejtë të të zbuluesës hyjnore, të interpretimeve të mesazhit hyjnor në gjuhën shqipe, për aspektin doktrinar dhe në vënien e raporteve të gjithanshme ndërshoqërore në kulturën shqiptare.

Të theksojmë se, meqë parafjalët në gjuhën arabe janë pjesë shërbyses që në vetvete nuk kanë kuptim përveç atëherë kur janë të varura prej pjesëve – fjalëve të tjera në fjali, ato nuk kanë ndonjë irregull formimi, megjithëse si veçori e tyre është se ato nuk i pranojnë veçoritë e emrit dhe të foljes, ndonëse kjo veçori nuk është karakteristike për çdo parafjalë. Pastaj për deri sa parafjalët në gjuhën shqipe vijnë vetëm në tre rasa të caktuara (emërore, kallëzore dhe rrjedhore),

në gjuhën arabe mund të vijnë në të gjitha rasat përkatëse gjuhësore (e cila gjithsejt i ka tri rasa: emërore, gjinore dhe kallëzore). Për dallim nga gjuha shqipe në të cilën parafjalët ndahen në tre lloje (sipas funksionit, strukturës dhe formimit), në gjuhën arabe ato ndahen në katër lloje edhe atë: siaps vendit ku vijnë, sipas pandryshueshmërisë, sipas numrit të shkronjave dhe sipas kuptimit. Prandaj Hulumtimi i një subjekti të tillë është i rëndësishëm nga aspekti shkencor me qëllim që të nxjerrë në pah ndikimin dhe vlerën e tyre në gjuhën dhe në kulturën shqiptare.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Tema e doktoraturës “*Funksioni i parafjalëve arabe në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe – Rasti i përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës*”, është një përpjekje për të pasqyruar funksionin e parafjalëve në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe.

Për shkak të natyrës së punimit (disertacion i doktoraturës), kandidati në konsultim me mentorin dhe me rekomandim të anëtarëve në konferencat doktorale është përcaktuar vetëm për parafjalët më të përdorura në gjuhën arabe, me theks të veçantë funksionin e tyre në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe. Pasi nga viti 1985 ka më shumë se një përkthim të Kur'anit në gjuhën shqipe, tema si objekt studimi ka vetëm përkthimin e Salih Ferhat Hoxhës, për shkak të stilit gjuhësor dhe rrethanave në të cilat është përkthyer, përkthim i cili nuk ka qënë i ndikuar nga përkthimet në gjuhë të tjera dhe i nejti, ndonëse është botuar më vonë, ka qenë i përkthyer para vitit 1985, vit kur janë botuar përkthimet e e para të plota të Kur'anit në gjuhën shqipe.

Tema ka rëndësi të veçantë edhe shkencore gjuhësore poor edhe rëndësi kulturore e shpirtërore, aq më tepër në përcjelljen e idësë dhe porosisë së Zbulësës hyjonre që është universale, me çka kandidati është munduar që të hap shfigje të reja në percjelljen e kësaj ideje dhe porosie në nënqiellin dhe në kulturën gjuhësore shqiptare duke vënë në dukje rëndësinë e përkthimit dhe përdorimit sa më të drejtë edhe të vetë parafjalëve arabe.

Pastaj për deri sa parafjalët në gjuhën shqipe vijnë vetëm në tre rasa të caktuara (emërore, kallëzore dhe rrjedhore), në gjuhën arabe mund të vijnë në të gjitha rasat përkatëse gjuhësore (e cila gjithsejt i ka tri rasa: emërore, gjinore dhe kallëzore). Për dallim nga gjuha shqipe në të cilën parafjalët ndahen në tre lloje (sipas funksionit, strukturës dhe formimit), në gjuhën arabe ato

ndahen në katër lloje edhe atë: siaps vendit ku vijnë, sipas pandryshueshmërisë, sipas numrit të shkronjave dhe sipas kuptimit.

Si përfundim, kandidati Mr. Dritan Skenderi vlerëson se me që parafjalët në gjuhën arabe janë të pandryshueshme, dhe shumica apo më të përdorshmet e tyre gjithmonë janë në rasën gjinore si الباء, من, إلى, عن, في, الكاف, اللام, وأو القسم, تاء القسم, حتى, منذ etj., shto kësaj që çdo parafjalë ka më shumë se tre-katër kuptime, ku për ilustrim ka përmendur se vetem parafjala الباء ka 16 kuptime, sigurisht se ka qenë i detyruar që të kufizohet vetëm në trajtimin dhe analizën e disa parafjalëve të caktuara më të përdorura, pasi kjo kërkon një hulumitim dhe punim shumë të zgjeruar dhe voluminoz, gjë që do ta stërmgarkonte dhe mbivështirësonte punën tonë.

Studimi përpinqet që në hollësi ti definojë parafjalët dhe funksionet e tyre dhe ta paraqesë ndikimin e tyre, me shembuj konkret, në përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, respektivisht në përkthimin e Salih Ferhat Hoxhës, si një përkthim më i pastër gjuhësor dhe kulturor shqiptar, i cili do të shërbejë edhe si ilustrues i pëkapjes, konceptimit dhe manifestimit të mesazhit të Zbulesës hyjnore në mentalitetin, kulturën dhe gjuhën shqipe.

Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të disertacionit së doktoraturës “*Funksioni i paraffjalëve arabe në përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe- Rasti i përkthimit të Salih Ferhat Hoxhës*” të kandidatit **Mr. Dritan Skenderi**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij Raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni për vlerësim:

1. Prof. Dr. Metin Izeti (Kryetar)

2. Prof. Dr. Sulejman Baki (anëtar)

3. Prof. Dr. Ziber Lata (anëtar)

4. Prof. Dr. Izmit Durmishi (anëtar)

5. Prof. Dr. Adnan Ismaili (Mentor)

Tetovë, 26.12.2023